

RAIFFEISEN INVEST S.H.A.

POLITIKA E INVESTIMEVE

FONDI RAIFFEISEN PRESTIGJ

V 1.3

Tabela e Lëndës

I.	Qëllimi	4
II.	Fusha e zbatimit.....	4
III.	Objektivat e Investimit.....	4
	Siguria.....	4
	Likuiditeti.....	5
	Yield-i.....	7
IV.	Investimet e Përshtatshme dhe të Lejuara.....	7
	Llojet e Investimeve	7
V.	Strategjia e Investimeve.....	8
	Diversifikimi.....	8
	Oferta Konkuruuese.....	9
VI.	Shpërndarja e Aseteve.....	9
VII.	Standartet e Performancës	1011
VIII.	Standartet.....	11
	Kujdesi Profesional	11
	Etika dhe Konflikti i Interesit	12
	Delegimi i Autoritetit.....	12
IX.	Raportimi.....	12
	Metodat.....	12
	Vlerësimi me vlerën e tregut të Portofolit të Tregtueshëm dhe Portofolit të Vlefshëm për Shitje	13
X.	Konsiderata të Politikës	13
	Përputhshmëria.....	13
XI.	Aprovimi i Politikës së Investimeve.....	13

AUTORI	Rezarta Arapi
NJËSITË/ROLET NËN NDIKIMIN E KËSAJ POLITIKE	Front Office – Menaxhim i Fondeve
APROVUAR NGA	Komiteti i Investimeve
MIRATUAR DHE EFEKTIVE NE	Shkurt 2012
NDRYSHUAR NE	Gusht 2014 ; Mars <u>01 Prill</u> 2016
LEGJISLACIONI	Ligji nr. 10198 “Mbi Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive” ; Ligji nr. 9879 “Mbi titujt”
RREGULLORE TE AMF	Rregullore nr 45 “Për Administrimin e Likuiditetit për Fondin e Investimeve”
DIREKTIVA TE GRUPIT	Direktiva për Menaxhimin e Fondeve të Investimit
MBAJTËSI I DOKUMENTIT	Drejtor i Menaxhimit te Fondeve

I. Qëllimi

Qëllimi i Politikës së Investimeve të Fondit Raiffeisen PRESTIGJ (referuar si Fondi në këtë dokument) është të sigurojë kuadrin rregullativ për menaxhimin e aseteve të fondit. Politika e investimeve përcakton parametra si objektivin e investimeve, strukturën e shpërndarjes së aseteve të fondit, kufizimet dhe përgjegjësitë.

Politika e Investimeve synon të formalizojë kuadrin brenda te cilit kryhet aktiviteti i investimit, në mënyrë që menaxhimi i aseteve të fondit të jetë efektiv dhe i kujdesshëm.

Ajo vendos direktivat e përgjithshme të investimit, të cilat janë mjaftueshmërisht të gjera në mënyrë që ti krijojnë Menaxherit të investimeve hapësirën e nevojshme për të vepruar sic duhet brenda parametrave të përgjegjësisë dhe autoritetit, të cilat janë specifike për ruajtjen sic duhet të aseteve të investuara.

II. Fusha e zbatimit

Kjo politikë është e vlefshme për të gjitha aktivitetet e shoqërisë administruese që lidhen me investimin e aseteve të Fondit Raiffeisen PRESTIGJ. Për fondet e tjera të investimit që shoqëria administruese ka nën manaxhim, do të zbatohen politika të tjera investimi.

III. Objektivat e Investimit

Ky fond është në monedhën LEK dhe i përshtatshëm për persona fizikë dhe juridikë. Objektivi i Fondit është që të maksimizojë kthimin nga investimi, duke synuar në të njëjtën kohë ruajtjen e kapitalit të investitorit dhe sigurimin e likuiditetit të nevojshëm në shërbim të arritjes së objektivit. Objektivat kryesore të Fondit sipas rradhës së prioriteteve janë siguria, likuiditeti dhe yield-i.

1. Siguria

Të gjitha vendimet për investime do të ndërmerren në mënyrë të atillë që të sigurojnë ruajtjen e principalit në të gjithë portofolin. Objektivi do të jetë të minimizohet rreziku i kredisë dhe i luhatjes së normave të interesit.

a. Rreziku i Kredisë

Raiffeisen Invest do të minimizojë rrezikun e kredisë, i cili është rreziku i humbjes për shkak të mos-shlyerjes pjesërisht ose plotësisht të të gjitha detyrimeve të emetuesit të titujve :

- Duke kufizuar investimet vetëm në llojet e titujve të përmendur në këtë Politikë Investimi seksioni VII.
- Duke përzgjedhur me kujdes institucionet financiare, komisionerë, ndërmjetës dhe këshilltarë me të cilët Raiffeisen Invest do të hyjë në marrëdhënie biznesi.
- Duke vlerësuar cilësinë dhe aftësinë e emetuesit për të përmbushur detyrimet e tij si dhe cdo lloj kufizimi të vendosur mbi emetuesin;
- Duke shitur në momentin e duhur letrat me vlerë të emetuesve me performancë në rënie, në mënyrë që të minimizohen humbjet nga principali.

b. Rreziku i Normave të Interesit

Raiffeisen Invest do të minimizojë rrezikun e normave të interesit, i cili është rreziku i rënies së vlerës së tregut të titujve si rezultat i uljes së normave të interesit, duke strukturuar portofolin e investimeve në maturitete të ndryshme, në mënyrë që të plotësohen kërkesat e investitorëve për shlyerje të kuotave, duke shmangur kështu nevojën për të shitur tituj në tregun e hapur përpara maturitetit.

Menaxhimi i rrezikut ndaj normave të interesit do të bëhet përmes diversifikimit në maturime të ndryshme të investimeve në letra me vlerë – tituj borxhi, investimit në depozita afat shkurtra dhe në instrumenta të tjera të Tregut të Parasë dhe duke e kufizuar maturitetin mesatar të portofolit në përputhje me këtë Politikë Investimesh. (shiko seksionin VI)

2. Likuiditeti

Portofoli i Investimeve duhet të mbetet mjaftueshëm likuid për të plotësuar të gjitha kërkesat për shlyerje brënda afatit të përcaktuar në Ligj, i cili është jo më shumë se 7 ditë kalendarike nga data e marrjes së një kërkesë të vlefshme për shitje.

Menaxhimi i duhur i likuiditetit është po aq i rëndësishëm për qëllimet e përmbushjes së kërkesave për shlyerje, si dhe për menaxhimin e flukseve hyrëse në përputhje me objektivat e përgjithshme të investimit.

Për të siguruar analizë efektive dhe menaxhimin e likuiditetit, pozicionet e likuiditetit të fondit Prestigj monitorohen në baza ditore. Kjo arrihet duke monitoruar dhe duke respektuar kufijtë e likuiditetit të përcaktuara sipas rregullores nr 45 “Për Administrimin e Likuiditetit për Fondin e Investimeve”.

Fondi duhet të mbajë “Asete likuide të cilësisë së lartë”, në një masë të mjaftueshme për të dhënë siguri të arsyeshme në mënyrë që :

- a) Të jetë në gjendje të përmbushë në çdo moment kërkesat për shlyerje, në përputhje me kushtet e përcaktuara në prospekt;
- b) Të respektojë detyrimet e tjera, të cilat ligjërisht fondi duhet t'i përmbushë;
- c) Të respektojë ato detyrime, mospërmbushja e të cilave sipas detyrimeve kontraktuale dëmton interesat e investitorëve në fond.

Masa e “Aseteve likuide të cilësisë së lartë”, duhet të jetë, në çdo kohë, të paktën sa vlera gjithsej neto e flukseve monetare dalëse e parashikuar për një periudhë 30-ditore në kushte të tensionuara të tregut. Ky kusht aplikohet përpjesetimisht me peshen e aktiveve të investuara në një treg “jo aktiv”

Kriteret për përcaktimin e asetëve si “Asete likuide të cilësisë së lartë” i referohen rregullores nr 45 “Për Administrimin e Likuiditetit për Fondin e Investimeve”

- **Limit i Likuiditetit (Cash Buffer)**

Për një menaxhim të kujdesshëm të rrezikut të likuiditetit, Fondi duhet të mbajë në çdo kohë të paktën 5% të asetëve të tij në mjete monetare dhe/ose instrumente me periudhë të mbetur maturimi jo më të gjatë se 7 ditë, kur ka një shkallë tepër të lartë sigurie se në fund të periudhës së maturimit këto instrumente do të paguhen, dhe 5% të asetëve të tij në instrumente me periudhë të mbetur maturimi deri në 1 muaj. Limit i likuiditetit përcaktohet në rregulloren nr 45 në rast se kushtet e tregut tregojnë për mungesë aktiviteti ose aktivitet të ulët tregtimi për asetet e fondit.

- **Maturime Afat - shkurtra**

Fondi synon të mbajë rreth 30% të portofolit në investime me maturitet deri në 12-muaj. Një pjesë e portofolit mund të vendoset në marrëveshjet e riblerjes që ofrojnë likuiditet afatshkurtër me maturim një ditë deri në maturim 6 muaj.

3. Yield-i

Portofoli i Investimeve do të ketë objektivin që të arrihet një kthim konkurrues investimi në përputhje me kushtet e tregut gjatë gjithë cikleve buxhetore dhe ekonomike, duke marrë parasysh kufizimet e rrezikut të investimeve dhe të nevojave për likuiditet.

Objektivi i kthimit nga investimi është i një rëndësie dytësore në krahasim me objektivat e sigurisë dhe të likuiditetit të përshkruar më sipër.

Pjesa kryesore e investimeve do të përqëndrohet në tituj, të cilët do të sigurojnë kthim nga investimi relativisht të kënaqshëm për nivelin e rrezikut të marrë përsipër.

Në mënyrë që të arrihet optimizimi i kthimit nga investimet, kompania e menaxhimit mund të shesë para afatit të maturimit letrat me vlerë që mbahen në portofolin e Tregtimit në rastet e mëposhtme:

- Kur një shkëmbim titujsh do të përmirësojë cilësinë, kthimin apo kohëzgjatjen mesatare të synuar të portofolit (average duration)
- Kur ka kërkesa për likuiditet
- Për realizimin e fitimeve kapitale nga tregtimi

IV. Investimet e Përshtatshme dhe të Lejuara

1. Llojet e Investimeve

Në përputhje me Ligjin nr. 10198, datë 10.12.2009 “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive”, dhe referuar Seksionit 6 të tij mbi “Politikat e investimit për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive me ofertë publike”, asetet e fondit do të investohen në instrumentet e mëposhtme, të lejuara nga legjislacioni lokal dhe nga kjo politikë investimi:

- Tituj të transferueshëm dhe instrumente të tjerë të Tregut të Parasë që tregëtohen në tregje të rregulluara ose në një bursë titujsh në

Republikën e Shqipërisë, në një shtet të Bashkimit European apo në një shtet tjetër të lejuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF)

- Depozita në institucione kreditimi, të rregjistruara në Republikën e Shqipërisë, në një nga shtetet anëtare të BE-së ose në një shtet të lejuar nga AMF-ja, të cilat mund të tërhiqen menjëherë ose që kanë afat maturimi jo me shumë se 12 muaj.
- Kuota të fondeve të investimit ose aksione të shoqërive të investimit, të licensuara sipas Ligjit nr. 10198 “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive” si dhe kuota ose aksione të sipërmarrjeve kolektive të investimit, të licensuara në përputhje me standardet e Bashkimit European.
- Instrumente financiarë derivativë
Marrëveshje të Blerjes dhe Riblerjes me kushtin që titujt që janë objekt i marrëveshjes të ndodhen brenda gamës së investimeve të lejuara, të përmendura në këtë paragraf.

V. Strategjia e Investimeve

1. Diversifikimi

Fondi investon kryesisht në tituj të qeverisë të emetuara dhe garantuara nga qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe nga autoritetet lokale shqiptare.

Investimet e Fondit përfshijnë letra me vlerë të të ardhurave fikse me maturitet të ndryshëm, që tregtohen në tregjet e rregulluara të Republikës së Shqipërisë, vendet e BE-së dhe vende të lejuara nga AMF. Këto tituj mund të emetohen nga qeveritë, autoritetet lokale dhe ndërkombëtare dhe nga shoqëri tregtare.

Ekspozimi në një letër me vlerë të një emetuesi të vetëm (me përjashtim emetimet e Qeverisë së Republikës së Shqipërisë) nuk mund të tejkalojë 30% të totalit të aseteve të fondit.

Në rastet kur portofoli i investimeve përfshin transaksione, të cilat përmbajnë instrumente derivativë, ekspozimi me një palë të vetme nuk mund të tejkalojë 10% të totalit të aktiveve në rastin e një institucioni kreditues të licensuar dhe 5% të totalit të aseteve në raste të tjera.

Maturiteti i investimeve në tituj borxhi do të zgjerohet deri në një masë të caktuar në mënyrë të tillë që kohëzgjatja mesatare e portofolit të mos jetë më shumë se 5.

Cash-i do të mbahet në bankat dhe institucionet e tjera të mëdha financiare si depozitë afat shkurtër me afat maturimi maksimumi deri në një vit.

Totali i investimit në Fonde të tjera Investimi nuk duhet të tejkalojë 30% të totalit të aseteve dhe 10% të totalit të aseteve të fondit në rastin e investimit në një fond të vetëm të Investimeve.

Fondet e investimit do të përzgjidhen në bazë të strukturës së tyre të portofolit, me kushtin që portofolet e tyre të përmbajne tituj të emetuara nga vende të Bashkimit Europian apo nga shtete të miratuara nga AMF. Fondi Prestigj do të investojë në fonde që kanë ngjashmëri themelore në drejtim të objektivit të investimeve dhe të profilit të njëjtë të rrezikut (fonde me investime në tregun e parasë dhe në të ardhura fikse).

Strategjia e diversifikimit do të përcaktohet dhe rishikohet në mënyrë periodike nga Komiteti i Investimit dhe Menaxheri i Investimeve.

Në përcaktimin e strategjisë së diversifikimit, rregullat e përgjithshme dhe kufizimet që do të zbatohen janë:

- Maturitetet e portofolit të investimeve do të jenë të tilla që të shmangët përqëndrimi i aseteve në një maturitet specifik. Maturitetet do të përdoren për të siguruar stabilitetin e të ardhurave dhe plotësimin e nevojave për likuiditete.
- Rreziku i luhatshmërisë së cmimeve të tregut do të kontrollohet nëpërmjet diversifikimit të maturiteteve.

2. Oferta Konkuruuese

Investimet në tregun primar do të kryhen me yield (cmim) konkurrues. Në rastet e blerjes në tregun sekondar, Menaxheri i fondit mund të sigurojë disa oferta nga tregu për të përzgjedhur ofertën më të përshtatshme.

VI. Shpërndarja e Aseteve

Sipas politikës së investimit, asetet e fondit do të shpërndahen në përputhje me dinamikën e tregut dhe strategjitë e brendshme të menaxhimit.

Shpërndarja e asetëve i referohet llojeve të ndryshme të asetëve që përmban portofoli i investimeve. Fondi Prestigj do të përbëhet kryesisht nga investime të të ardhurave fikse. Objektivi i shpërndarjes së asetëve tregon se fokusi do të jetë në investime në tituj të Qeverisë Shqiptare.

Instrumenti	Objektivi*
Tituj të emetuar dhe garantuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë	90%
Tituj të emetuar dhe garantuar nga shtete dhe autoritete të Bashkimit Europian, organizata ndërkombëtare apo shtete të lejuara nga AMF	0%
Depozita Bankare, Marreveshje te Riblerjes (REPO), mjete monetare dhe ekuivalente te tyre	6%
Tituj të emetuar dhe garantuar nga autoritetet vendore dhe shoqëri tregtare të Republikës së Shqipërisë	2%
Kuota të Fondeve të Investimit	2%
Tituj të transferueshëm dhe instrumente të tjerë financiarë të borxhit që tregtohen në tregje të rregulluara ose bursë titujsh në një shtet të Bashkimit Europian, apo në shtete të lejuara nga AMF	0%
Instrumente financiare derivativë	0%

Objektivi publikohet në prospektin e Fondit dhe është përdorur për qëllime orientuese.*

Objektivi mund të ndryshohet duke marrë parasysh kushtet e tregut.

Ribalancimi: Shpërndarja e asetëve të fondit do të jetë sa më afër të jetë e mundur me objektivin. Nëse për shkak të zhvillimeve të shpejta dhe të papritura të tregut ose ndryshimeve në kushtet ekonomike, do të ndodh që shpërndarja e asetëve të jetë jashtë objektivit të kësaj politike, atëherë do të bëhen përpjekjet për të rivendosur shpërndarjen strategjike të asetëve dhe do të njoftohet Komiteti i Investimeve.

VII. Standartet e Performancës

Në mungesë të standardeve zyrtare të pranuarra gjerësisht në tregun shqiptar, si pikë referimi (performancë e synuar) për kthimin nga fondi do të jetë tejkalimi i normës mesatare të interesit për depozitat me afat 12 muaj në monedhën LEK, ofruar nga sistemi bankar.

VIII. Standartet

1. Kujdesi Profesional

Shoqëria administruese Raiffeisen Invest do të manaxhojë fondin, duke zbatuar “Rregullin e Personit të Kujdesshëm”, sipas të cilit cdo investim duhet bërë me gjykim dhe maturi, në të njejtat rrethana kur një person i kujdesshëm, do të ushtronte me zgjuarsiri dhe pjekuri administrimin e pasurive të veta, jo për spekulim, por për investim, duke konsideruar mundësitë e ruajtjes së kapitalit dhe mundësinë e të ardhurave që do të fitonte si rezultat i këtij investimi.

Menaxherët e Fondit që veprojnë në përputhje me procedurat e shkruara, me Direktivën e Raiffeisen Group për Menaxhimin e Fondeve të Investimit dhe sipas kësaj politike të investimeve, duke ushtruar kujdesin e duhur, do të lirohet nga përgjegjësia personale në rast të rrezikut të kredisë së një letre me vlerë ose të ndryshimeve në çmimin e tregut kur shmangiet nga pritshmëritë janë raportuar në kohë dhe shitja e titujve është kryer në përputhje me kushtet e kësaj politike. Fondi do të menaxhohet me një shkallë të lartë profesionalizmi, të denjë për besimin e publikut.

Menaxherët e fondeve janë të detyruar të veprojnë në mënyrë të drejtë, të ndershme dhe etike, në përputhje me ligjet rregulluese të zbatueshme për fondet, rregullat e fondit dhe prospektet si dhe të gjitha rregullat e tjera në fuqi, rregulloret dhe vendimet e Komitetit të Investimeve, vetëm në interesin më të mirë të investitorëve.

Menaxherët e fondeve janë të autorizuar të kryejnë investime në emër të fondit vetëm në përputhje me politikën e Investimeve të fondit dhe profilin e rrezikut të fondit, vetëm përmes ndërmjetësve të miratuar ose me palë të miratuar me limit kredie të mjaftueshëm dhe vetëm në instrumente financiarë të ligjshëm.

Menaxherët e fondeve janë të detyruar të veprojnë me kujdes profesional dhe maturi, në interesin më të mirë të investitorëve të fondit.

E vetmja arsye për menaxherët e fondeve për të bërë investime në emër të fondit janë ekzekutimi i politikës së Investimeve të fondit, në përputhje me profilin e rrezikut të fondit ose sigurimi i likuiditetit (cash) për të paguar shlyerjet nga fondi. Arsye të tjera për investime janë të ndaluara.

Menaxherët e fondeve janë të detyruar që në çdo investim në emër të fondit të kenë informacionin e mjaftueshëm në lidhje me instrumentin financiar, që janë duke tregtuar, dhe ta kuptojnë atë produkt siç duhet.

Kjo përfshin në veçanti identifikimin dhe të kuptuarit të të gjitha rreziqeve, të lidhur me instrumentin dhe derivativet e mundshme, të cilat mund të jenë të përfshira në instrument.

Menaxherët e fondeve janë të detyruar të marrin të gjitha masat e arsyeshme për të marrë rezultatin më të mirë të mundshëm për fondin, duke marrë parasysh çmimet, shpenzimet, shpejtësinë dhe mundësitë për ekzekutimin e pagesës, madhësinë dhe natyrën e urdhërit, ose çdo konsideratë tjetër që lidhet me ekzekutimin e investimit në zbatimin e vendimeve për menaxhimin e aseteve të fondit.

2. Etika dhe Konflikti i Interesit

Punonjësit e përfshirë në aktivitetin e investimeve nuk duhet të ushtrojnë asnjë aktivitet privat i cili do t'i pengonte ata për të ndjekur procesin e investimit në mënyrën e duhur, apo do të dëmtonte aftësinë e tyre për të marrë vendime të paanshme. Punonjësit përgjegjës për investimet duhet të deklarojnë nëse kanë interesa materiale në institucionet financiare me të cilat kanë marrëdhënie biznesi, apo cdo pozicion financiar/investim i cili mund të jetë i lidhur me performancën e portofolit të investimeve.

3. Delegimi i Autoritetit

Autoriteti për të zbatuar politikën e investimeve dhe menaxhuar asetet e Fondit i jepet Menaxherit të Investimeve, i cili duhet të veprojë në përputhje me procedurat e shkruara e të aprovuara dhe të jetë konsistent me politikën e investimeve.

IX. Raportimi

1. Metodat

Menaxheri i Fondit raporton dhe paraqet zhvillimin e fondit dhe statusin aktual të portofolit të investimeve në mbledhjet e Komitetit të Investimeve. Raporti përmban informacion për sa më poshtë :

- Vlera Neto e Aseteve të Fondit dhe Kthimi Neto vjetor
- Informacion me të fundit për performancën e fondit
- Shpërndarja e asetëve të fondit sipas maturitetit
- Transaksionet të ekzekutuara që nga mbledhja e fundit e Komitetit të Investimeve

Menaxheri i Fondit përgatit një raport mujor për investitorët (Gazetë), e cila ofron një analizë të gjendjes së portofolit aktual të investimeve.

2. Vlerësimi me vlerën e tregut të Portofolit të Tregtueshëm dhe të Portofolit të Vlefshëm për Shitje

Vlera e tregut e portofolit të tregtueshëm dhe të portofolit të vlefshëm për shitje do të përlllogaritet cdo ditë. Kjo do t'i sigurojë menaxherit të fondit një pamje të qartë mbi portofolin e investimeve, në aspektin e vlerës dhe luhatshmërisë së çmimeve në treg.

Një rregullore e brendshme që përcakton metodologjinë për llogaritjen e vlerës së tregut të portofolit të tregtueshëm dhe të vlefshëm për shitje është përdorur për këtë qëllim.

X. Konsiderata të Politikës së Investimeve

1. Përputhshmëria

Të gjitha investimet duhet të kryhen në përputhje me udhëzimet e kësaj politike. Nëse për ndonjë arsye kërkesat e kësaj politike nuk janë përmbushur, Investimet duhet të rikthehen në përputhje me këtë politikë brenda një muaji apo Komitetit i investimeve duhet të paraqitet me një plan nëpërmjet të cilit investimet do të sigurojnë këtë përputhshmëri.

XI. Aprovimi i Politikës së Investimeve

Politika e investimeve është objekt i shqyrtimit dhe miratimit nga Komiteti i Investimit dhe çdo ndryshim duhet të aprovohet nga ky organ.